



THIRRJE PËR SHPREHJE INTERESI

Kosovo Trade Mission to the United Kingdom

Londër | 21–25 shtator 2026

Mundësia: Deri në 12 kompani të sektorit TIK nga Kosova do të për zgjidhen për një program të orientuar drejt krijimit të lidhjeve konkrete me tregun e Mbretërisë së Bashkuar.

UK–Kosovo Tech Hub organizon Kosovo Trade Mission to the United Kingdom dhe fton kompanitë e sektorit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në Kosovë që të shprehin interesin për pjesëmarrje.

Misioni synon t’u krijojë kompanive të për zgjedhura qasje të strukturuar në tregun britanik, kontakte të reja biznesi, mundësi për prezantimin e shërbimeve dhe njohje me zhvillimet ndërkombëtare që ndikojnë sektorin digjital.

UK–Kosovo Tech Hub është një iniciativë e STIKK që mbështetet nga ProCredit Bank Kosova dhe Ambasada Britanike në Kosovë. British Kosovar Chamber of Commerce (BKCC) dhe Ambasada e Kosovës në Mbretërinë e Bashkuar janë partnere e këtij misioni.

Çfarë përfshin pjesëmarrja?

- Takime B2B të organizuara paraprakisht me biznese dhe partnerë potencialë që operojnë në Mbretërinë e Bashkuar;
- Qasje në ngjarje rrjetëzuese dhe aktivitete që mundësojnë krijimin e kontakteve profesionale;
- Pjesëmarrje në evente dhe panaire ndërkombëtare që mbulojnë tregtinë elektronike dhe shitjet digjitale, marketingun digjital dhe përvojën e klientit, të dhënat, analitikën dhe inteligjencën artificiale, si dhe operacionet digjitale, logjistikën dhe zgjidhjet teknologjike;
- Përgatitjen e një profili/portofoli të kompanisë në gjuhën angleze, i cili do të ndahet paraprakisht me organizatorët dhe bizneset relevante në Mbretërinë e Bashkuar;
- Identifikimin dhe komunikimin paraprak të interesimit nga bizneset britanike për kompanitë e delegacionit;
- Mbështetje për regjistrimet në aktivitetet përkatëse dhe për procesin e takimeve B2B përmes platformës b2match;
- Planifikimin e agjendës dhe koordinimin logjistik të misionit;

- Transportin lokal në Londër për aktivitetet zyrtare të delegacionit, nga pikat e takimit që do të komunikohen paraprakisht;
- Një darkë të përbashkët të delegacionit gjatë misionit;
- Letra mbështetëse për aplikimin për vizë nga partnerët relevantë, sipas mundësive dhe procedurave të tyre.

E rëndësishme: Organizatorët nuk ofrojnë këshillim për vizë dhe nuk mund të garantojnë lëshimin e saj. Çdo aplikant mbetet përgjegjës për aplikimin, dokumentacionin dhe respektimin e afateve të autoriteteve britanike.

Kriteret e pjesëmarrjes

- Kompania të jetë e regjistruar në Republikën e Kosovës;
- Kompania të veprojë në sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;
- Kompania të demonstrojë interes dhe kapacitet për zhvillimin e marrëdhënieve të biznesit në tregun e Mbretërisë së Bashkuar;
- Të paktën një përfaqësues i kompanisë të jetë në gjendje të komunikojë dhe të prezantojë kompaninë në gjuhën angleze;
- Kompania të angazhohet në përgatitjet paraprake dhe në agjendën e plotë zyrtare të misionit.

Numri i pjesëmarrësve

Do të përzgjidhen maksimumi 12 kompani. Secila kompani mund të nominojë maksimumi dy (2) përfaqësues. Dorëzimi i më shumë se një emri nuk i jep kompanisë përparësi gjatë përzgjedhjes.

Procesi i përzgjedhjes

Fillimisht do të verifikohet përmbushja e të gjitha kriterëve të publikuara dhe plotësia e aplikimit. Ndër aplikimet e vlefshme do të zbatohet parimi “first come, first served”, sipas datës dhe orës së dorëzimit të aplikimit të plotë.

Në rast se numri i aplikimeve të vlefshme tejkalon 12, kompanitë e tjera do të vendosen në listë pritjeje sipas të njëjtit rend. Kompanitë do të njoftohen për rezultatin brenda një (1) dite pas përfundimit të afatit të aplikimit.

Kostot dhe përgjegjësitë e kompanive

Pjesëmarrja në programin e misionit nuk ka tarifë. Secila kompani mbulon vetë:

- udhëtimin vajtje-ardhje Kosovë–Londër;
- akomodimin në Londër;
- tarifën dhe shpenzimet e aplikimit për vizë;
- sigurimin e udhëtimit;
- transportin ndërmjet aeroportit dhe akomodimit;
- ushqimet që nuk janë pjesë e agjendës zyrtare dhe çdo shpenzim personal.

Si të aplikoni

Aplikimi bëhet përmes formularit në Google Form: <https://forms.gle/67KnKfTv9UUM1z5p8>. Formulari duhet të plotësohet vetëm një herë për secilën kompani dhe të gjitha fushat e detyrueshme duhet të përmbajnë informacion të saktë dhe të plotë.

Thirrja do të qëndrojë e hapur deri më datë 18 Gusht 2026, ora 12:00. Aplikimet e paplota, aplikimet e dorëzuara pas afatit ose aplikimet e kompanive që nuk i plotësojnë kriteret nuk do të merren në konsideratë.

Pas përzgjedhjes: Kompanive të përzgjedhura do t'u dërgohen menjëherë informatat për regjistrimet e nevojshme, kërkesat për përgatitjen e profilit në anglisht dhe udhëzimet për hapat vijues. Agjenda e detajuar do të ndahet me delegacionin e konfirmuar.

Përdorimi i informacionit

Duke aplikuar, kompania pajtohet që informacioni profesional dhe profili i saj të përdoren nga UK–Kosovo Tech Hub, STIKK dhe partnerët e përfshirë vetëm për organizimin e misionit, promovimin e delegacionit dhe realizimin e takimeve me biznese potenciale në Mbretërinë e Bashkuar.



Ambasada e Republikës së Kosovës në Londër
Embassy of the Republic of Kosovo in London



British Embassy
Pristina



THE BRITISH-KOSOVAR
CHAMBERS OF COMMERCE